

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXV, nr. 7994  
E hënë, 17 shkurt 2025  
Çmimi 0.50

KQZ-ja: Janë numëruar 63.60 % e vendvotimeve | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## NJOHJET QË S'I ERDHËN KURRË: KUSH IA MBYLLI DYERT KOSOVËS? | FAQE 4-5



Shtatëmbëdhjetë vjet pas shpalljes së pavarësisë, Kosova është në harresë diplomatike - e njohur nga

shumë shtete, por jashtë disa organizatave më të rëndësishme ndërkombëtare. Me dinamikat e shpejta

gjeopolitike, vëzhguesit thonë se Kosova rrezikon ta humbasë edhe mbështetjen e disa vendeve me ndikim

TRUMPI E URON PRESIDENTEN OSMANI PËR PËRVJETORIN E PAVARËSISË SË KOSOVËS | F. 3



KOSOVA NËNSHKRUAN KONVENTËN E LUBJANËS-HAGËS PËR HETIMIN E KRIMEVE TË LUFTËS | F. 3



### OPINION

REFUZIMI QË PRESIDENTI THAÇI TA VIZITOJË BABANË E SËMURË ËSHTË DËNIM SHITESË QË SHKON PËRTEJ KUFIJVE TË DREJTËSISË PENALE | F. 6

Shkruan:  
Sali BISLIMI



### AKTUALE



RUBIO NË IZRAEL, THOTË SE HAMASI DUHET TË "SHFAROSET" | F. 3

PËR NDER TË 17 SHKURTIT, NË SHESHIN E ÇIKAGOS U NGRIT FLAMURI I KOSOVËS | F. 3

### EKONOMI



ÇMIMET E LARTA TKURRIN BLERJET | F. 8

### SPORT

LIGA					
SPIELTAG 16					
	SP	TV	TD	P	
1. FC KOSOVA	20	54:18	36	45	
2. VFL JUCHEN	20	49:20	29	45	
3. FC REMSCHEID	20	41:22	19	42	
4. HOLZHEIM	20	45:29	16	39	
5. ASV SUCHTELN	20	50:33	17	37	
6. VFB HILDEN 03 II	20	46:29	17	33	

FC KOSOVA DÜSSELDORF MERR KREUN E TABELËS NË LANDESLIGA | F. 8

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501289

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

# Rubio në Izrael, thotë se Hamasi duhet të “shfaroset”

**JERUSALEM, 16 SHKURT** - Sekretari amerikan i Shtetit, Marco Rubio, tha të dielën se i mbështet plotësisht synimet e Izraelit në luftën e tij në Rripin e Gazës, duke thënë se Hamasi “duhet të shfaroset patjetër”. Hamasi është shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian.

Rubio u takua me kryeministrin e Izraelit, Benjamin Netanyahu, në Jerusalem, në fillim të turneut të tij në Lindjen e Mesme, ku ka shumë mundësi të përballit me kundërshtime nga liderët arabë lidhur me planin e presidentit Donald Trump për ta zhvendosur popullsinë palestineze jashtë Rripit të Gazës dhe për ta rindërtuar enklavën palestineze duke e vendosur nën pronësi amerikane.

Netanyahu e ka mirëpritur planin dhe tha se ai dhe Trumpi kanë “strategji të përbashkët” për të ardhmen e Gazës.

Duke iu bërë jehonë fjalëve të Trumpit, Netanyahu tha se “dyert e ferrit do të hapen” nëse Hamasi nuk i liron dhjetëra pengje të mbetura në Gazë, që ishin rrëmbyer gjatë sulmit të 7 tetorit 2023, i cili e shkaktoi luftën.

Këto deklarata erdhën vetëm dy javë para përfundimit të fazës së parë të armëpushimit në mes të Izraelit dhe Hamasit. Faza e dytë e armëpushimit, në të cilën Hamasi duhet t'i lirojë dhjetëra pengje të mbetura në këmbim të shumë të burgosurve palestinezë dhe forcat izraelite të tërhiqen nga Gaza, ende nuk është negociuar.

Rubio tha se Hamasi “nuk mund të vazhdojë si forcë ushtarake apo qeveritare”. “Përderisa [Hamas] vazhdon si forcë që mund të qeverisë, si forcë që mund të administrojë ose si forcë që mund të kërcënojë me përdorimin e dhunës, paqja është e pamundur”, tha Rubio. “Ai [Hamas] duhet të shfaroset”, shtoi ai.

Kjo mund t'i ndërllojë përpjekjet për vazhdimin e bisedimeve me Hamasin, i cili me gjithë humbjet e pësuar vazhdon ta kontrollojë Gazën. Netanyahu ka shfaqur gatishmëri për ta rinisur luftën pas fazës së tanishme dhe i ka ofruar Hamasit mundësi për t'u dorëzuar dhe për t'i dërguar liderët e tij të lartë në mërgim. Hamasi e ka hedhur poshtë këtë.

Ndërkohë, në një intervistë për radio javën e kaluar, Rubio tha se propozimi i Trumpit ishte pjesërisht i destinuar për të ushtruar tryzni mbi shtetet arabe për të propozuar një plan që do të ishte i pranueshëm për Izraelin, sipas të cilit, Hamasi nuk mund të ketë rol në Gazë. Ai, gjithashtu, duket se sugjeroi se shtetet arabe duhet të dërgojnë trupa për të luftuar kundër Hamasit. “Nëse dikush ka një plan më të mirë, dhe shpresojmë që ata ta kenë, nëse shtetet arabe kanë një plan më të mirë, atëherë shumë është”, tha Rubio të enjten.

Por, “Hamasi ka armë”, shtoi ai. “Dikush duhet të përballit me



ta. Nuk do të jenë ushtarët amerikanë. Dhe nëse shtetet në rajon nuk mund ta zgjidhin këtë pjesë, atëherë Izraeli do të duhet ta bëjë dhe pastaj do të kthehemi aty ku ishim”. Rubio nuk pritet të takohet me asnjë palestinez gjatë turneut të tij. Për liderët arabë lehtësimi i shpërnguljes masive të palestinezëve ose luftimi i luftëtarëve palestinezë në emër të Izraelit janë të dy skenarë makthi. Për secilin prej tyre ata do të përballëshin me kritika të

ashpra brenda vendit dhe mund ta destabilizojnë një rajon tashmë të paqëndrueshëm. Egjipti thotë se do të jetë nikoqir i një samiti arab më 27 shkurt dhe po punon me shtetet e tjera për një kundërpropozim që do ta lejonte rindërtimin e Gazës pa zhvendosjen e popullsisë së saj. Grupet për të drejtat e njeriut thonë se shpërngulja e palestinezëve do të ishte në kundërshtim me ligjin ndërkombëtar.

## Ukraina dhe ShBA-ja peshojnë marrëveshjen për mineralet e rralla

**KIEV, 16 SHKURT** - Rezervat e mëdha me minerale të rralla i japin Ukrainës mundësi të për të qenë një furnizuese strategjike për Perëndimin. Presidenti Donald Trump po shqyrton një marrëveshje që do ta siguronte vazhdimin e mbështetjes amerikane për Ukrainën në luftën kundër Rusisë në këmbim të qasjes të mineralet e saj. Siç njoftojnë korrespondentët e Zërit të Amerikës, Myroslava Gongadze nga Varshava, dhe Anna Chernikova nga Kievi, ky propozim po diskutohet gjatë Konferencës së Sigurisë në Munihi.

Miniera Zavallivsky në Ukrainën qendrore ka një nga depozitat më të mëdha të grafinës në Evropë, një material kyç për bateritë e automjeteve elektrike dhe reaktorët bërthamorë. Kjo është një nga rezervat e mëdha të mineraleve të rralla që synojnë Shtetet e Bashkuara ndërsa përpiqen ta ulin varësinë nga Kina për materiale të tilla. Drejtuesit e minierës thonë se



me investimet e duhura ajo mund të bëhet një lojtare globale në sektorin e grafinës. “Bëhet fjalë për miliarda dollarë dhe vite investime. Qeveria ukrainase duhet të punojë ngushtë me partnerët amerikanë, evropianë dhe lojtarë të fuqishëm në mbarë botën për të bërë një lëvizje në këtë proces, për ta krijuar këtë bazë së bashku”, thotë Ostop Kostyuk, drejtues i minierës së grafinës, Zavallivsky. Qeveria ukrainase thotë se vendi i saj ka depozita minerale

të 22 nga 50 materialet strategjike të identifikuar si kritike nga Shtetet e Bashkuara. Po ashtu, ka 25 nga 34 mineralet që Bashkimi Evropian i ka klasifikuar si tejet të rëndësishme.

Bëhet fjalë për grafinë, litium, titanium dhe uranium, minerale thelbësore për industrinë e mbrojtjes, energjinë e gjelbër dhe industrinë e teknologjisë së lartë. Ekspertët thonë se Ukraina ka potencial të lartë, por kërkohen investime të mëdha për t'i

shfrytëzuar këto rezerva. Zëri i Amerikës bisedoi me Mariia Kurylo, e cila është me Komisionin Shtetëror për Burimet Minerale. “Projektet për mineralet e rralla jo vetëm që janë shumë të rëndësishme, por janë strategjike për zhvillimin, jo vetëm për partnerët perëndimorë, por edhe për zhvillimin tonë”.

Kompania ukrainase BGV, e cila investon në miniera, thotë se ka shpenzuar 100 milionë dollarë në projekte të mineraleve kritike, por për t'i rritur operacionet kërkohen investime shtesë prej qindra miliona dollarësh.

Zëri i Amerikës bisedoi me Serhii Voitshovskiy, anëtar bordi i kompanisë ukrainase të investimeve minerare, BGV. “Zhvillimi i minierës së grafinës në Balakhivka kërkon investim kapitali prej rreth 450 milionë dollarësh”.

Ndërsa Amerika dhe vendet e tjera perëndimore kërkojnë ta ulin varësinë nga Kina për minerale kritike, Ukraina sheh një mundësi për ta forcuar

ekonominë dhe sigurinë e saj. “Kemi një strategji që sjell përfitime në çdo aspekt. Partnerët kanë nevojë për këto materiale, që në të vërtetë janë produkte me vlerë të lartë”, thotë Serhii Voitshovskiy me firmën BGV.

Amerika dhe Evropa janë përpjekur ta ulin varësinë e tyre nga Kina, furnizuesja kryesore në botë me minerale të rralla. Roman Opimakh ka qenë drejtor i përgjithshëm i Shërbimit Gjeologjik të Ukrainës. “Ukraina do ta ndihmojë Evropën dhe Amerikën për ta ulur varësinë nga Kina dhe pjesërisht nga Rusia. Në të njëjtën kohë forcon qëndrueshmërinë në vend. Investimet e shumta dhe furnizimet e larta mund të funksionojnë si një kupolë e hekurit për Ukrainën”. Ai thotë se partneriteti është strategjik dhe ekonomik. Pavarësisht prej luftës dhe humbjeve të mundshme të territoreve, ai thotë se shumica e mineraleve kritike mbeten nën kontrollin e Kievit.

## Për nder të 17 shkurtit, në sheshin e Çikagos u ngrit flamuri i Kosovës

Prishtinë, 16 shkurt - Për nder të 17-vjetorit të Pavarësisë, të premtën në Çikago është bërë ngritja e flamurit të Republikës së Kosovës në sheshin Daley Plaza, përkrah flamujve të Shteteve të Bashkuara dhe të qytetit të Çikagos. Kështu u bë me dije në njoftimin e lëshuar nga Konsullata e Kosovës në Des Moines të Shteteve të Bashkuara.

Drejtuesi i konsullatës, Dylon Zogaj, gjatë ceremonisë i ka falënderuar drejtuesit e Komuniteti Shqiptar në "Illinois-Albanian Community of Illinois" për shënimin e përvitshëm të pavarësisë së Kosovës si dhe për përkushtimin e tyre të përhershëm për Kosovën dhe bashkatdhetarët tanë në Illinois.

Gjatë ditës përfaqësuesit e konsullatës kanë zhvilluar një takim me drejtuesit e Komunitetit Shqiptar në Illinois, të shoqatës "Dardania", me përfaqësuesit e pjesëtarëve të Policisë së Çikagos nga shoqata "Shqiptaro-Amerikane e Zbatuesve të Ligjit" në Illinois, si dhe pjesëtarë të komunitetit të bashkatdhetarëve.



# Trumpi e uron presidenten Osmani për përvjetorin e Pavarësisë së Kosovës

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 16 SHKURT - Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Donald Trump, e ka uruar presidenten e Kosovës, Vjosa Osmani, për 17-vjetorin e Pavarësisë së vendit, njoftoi Presidenca të dielën. Presidenca e Kosovës tha në një njoftim për medie se në mesazhin e tij, Trumpi e "përgëzoi popullin e Kosovës për rrugëtimin drejt pavarësisë, duke vënë në pah qëndrueshmërinë dhe vendosmërinë që e kanë shoqëruar këtë proces". Qytetarët e Kosovës do ta shënojnë të hënën përvjetorin e Pavarësisë, të cilën Prishtina e shpalli më 2008 me ndihmën e Shteteve të Bashkuara. Në letrën e Trumpit, sipas Presidencës së Kosovës, thuhet se "lidhjet midis popujve tanë

janë të forta dhe ne presim me padurim t'i zgjerojmë ato, veçanërisht përmes rritjes së mundësive për investime, me qëllim që të sjellim më shumë prosperitet për të dyja vendet tona".

Shtetet e Bashkuara do të vazhdojnë të punojnë me Kosovën për forcimin e institucioneve demokratike dhe promovimin e rritjes ekonomike përmes një mjedisi të qëndrueshëm dhe të drejtë biznesi, citohet të ketë thënë Trumpi në mesazhin e tij.

Në fillim të shkurtit, presidentja Osmani tha se me administratën e re amerikane të presidentit Donald Trump, Kosova synon ta thellojë bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes e të investimeve strategjike.

Osmani zhvilloi një mori takimesh me zyrtarë amerikanë dhe kongresistë në Uashington në fillim të



shkurtit, u takua me nënpresidentin JD Vance më 11 shkurt në një samit botëror për inteligjencë artificiale në Paris, si dhe takoi delegacione të senatorëve dhe kongresistëve amerikanë këtë fundjavë në margjinat e Konferencës së Sigurisë në Munihi.

Në letrën e tij, Trumpi tha se

ShBA-ja mezi pret të ndërtojë lidhje më produktive me Qeverinë e Kosovës në vazhdim të këtij viti. Kosova pret të ketë qeveri të re pas zgjedhjeve parlamentare të 9 shkurtit të cilat i fitoi partia në pushtet e kryeministrit Albin Kurti, por pa arritur ta sigurojë shumicën e nevojshme prej 61

deputetësh për ta formuar e vetme qeverinë.

Letra e Trumpit pason kritikata që i dërguari i tij për misionet të veçanta, Richard Grenell, i bëri ndaj qeverisë së kryeministrit Kurti më 3 shkurt, kur tha se ShBA-së i duhen partnerë të besueshëm në Ballkan, ndërsa ajo e Kurtit nuk është e tillë.

Ndërkohë, Trumpi nuk e përmendi në urimin e tij drejtuar Osmanit dialogun për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Trumpi nuk e përmendi dialogun as në urimin drejtuar presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiq për ditën e shtetësisë së Serbisë javën e kaluar.

Kosova dhe Serbia dialogojnë në Bruksel - me ndërmjetësim të Bashkimit Evropian - që prej vitit 2011. Ato kanë arritur një mori marrëveshjesh, por jo të gjitha janë zbatuar.

## KQZ-ja: Janë numëruar 63.60 % e vendvotimeve



PRISHTINË, 16 SHKURT - Sipas të dhënave të pranuar nga Qendrat Komunale të Numërimit, në të cilat është duke vazhduar apo ka përfunduar procesi i numërimit të votave të kandidatëve për deputetë nga zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, deri më 16 shkurt 2025, ora 16:00, janë

numëruar 63.60 % e vendvotimeve apo 1 611 nga 2 533.

Procesi i numërimit të votave ka përfunduar në 14 Qendrat Komunale të Numërimit (QKN) në komunat: Deçan, Kamenicë, Novobërdë, Obiliq, Shtërpçë, Suharekë, Viti, Junik, Mamushë, Hani i Elezit, Ranillug, Partesh,

Kllokot dhe Mitrovicë e Veriut.

Më 16 shkurt, në orën 16:00, procesi i numërimit ka filluar edhe në QKN-në e komunave Leposaviq, Zveçan dhe Zubin Potok.

Në përgjithësi, procesi i numërimit është duke vazhduar në 24 Qendra Komunale të Numërimit.

## Ushtarë letonezë dhe italianë të KFOR-it patrullojnë në Zubin Potok

Prishtinë, 16 shkurt - Ushtarë letonezë të caktuar në Komandën Rajonale Lindje dhe ushtarë italianë nga Batalioni i Forcave Operacionale Rezervë të KFOR-it kanë patrulluar në Zubin Potok në veri të Kosovës. Misioni paqeruajtës i NATO-s ka njoftuar se ushtarët "kryen një patrullë rutinë" për ta garantuar sigurinë dhe lirinë e

lëvizjes në atë zonë. "Këto përpjekje janë pjesë e misionit të përditshëm të KFOR-it për të garantuar një mjedis të sigurt dhe të qetë për të gjithë njerëzit që jetojnë në Kosovë", është thënë në njoftim.

KFOR-i ka theksuar se si zakonisht vazhdon ta zbatojë mandatin e tij për të kontribuar në një mjedis të sigurt dhe të

qetë për të gjithë njerëzit dhe komunitetet që jetojnë në Kosovë dhe lirinë e lëvizjes, në çdo kohë dhe në mënyrë të paanshme.

KFOR-i përsëriti se punon në koordinim të ngushtë me Policinë e Kosovës dhe Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX).





# NJOHJET QË S'I ERDHËN KURRË: KUSH IA MBYLLI DYERT KOSOVËS?

Shtatëmbëdhjetë vjet pas shpalljes së pavarësisë Kosova është në harresë diplomatike - e njohur nga shumë shtete, por jashtë disa organizatave më të rëndësishme ndërkombëtare. Me dinamikat e shpejta gjeopolitike, vëzhguesit thonë se Kosova rrezikon ta humbasë edhe mbështetjen e disa vendeve me ndikim

**PRISHTINË, 16 SHKURT** - Në vitin kur Kosova shpalli pavarësinë, më 2008, kryeministri i atëhershëm i vendit, Hashim Thaçi, premtoi njohje nga 193 shtete, që i binte të gjitha vendet anëtare të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, plus një. "Unë konfirmoj përsëri se shteti i Kosovës do të njihet jo

nga 100, por nga 193 shtete. Po të krahasohen njohjet e Kosovës me republikat e tjera të dala nga ish-Jugosllavia, te ne ka ndodhur mrekullia", tha Thaçi. Ai i bëri këto komente në një seancë të Kuvendit të Kosovës në mes të korrikut 2008, pesë muaj pas shpalljes së

pavarësisë. Me gjithë kundërshtimet e Serbisë, vendi atëkohë njihet nga 43 shtete të botës, përfshirë ShBA-në dhe fuqitë kryesore evropiane. Dy vjet më vonë Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë - në përgjigje të kërkesës së Serbisë për opinion - shpalli vlefshmërinë e Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës, duke thënë se ajo nuk binte në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare. Për autoritetet në Kosovë atëkohë kjo ishte edhe një shtysë që demokracia më e re në botë të njihet ndërkombëtarisht "sepse, më në fund, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë - një institucion i vlerësuar i drejtësisë - konfirmoi se populli i Kosovës bëri gjënë e duhur, duke shpallur

pavarësinë e tij më 17 shkurt 2008", tha ministri i atëhershëm i Punëve të Jashtme të Kosovës, Skender Hyseni, pas vendimit të GJND-së. Shtatëmbëdhjetë vjet më vonë, në listën që ka të publikuar Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës në Kosovë në uebfaqen e saj, figurojnë 117 vende që e njohin Kosovën - ende larg shifrës së premtuar prej 193. Shteti i fundit që e njohu ishte Izraeli në vitin 2021. Kjo njohje ishte pjesë e Marrëveshjes së Uashingtonit në mes të Kosovës dhe Serbisë. Para saj, shteti i fundit që e njohu ishte Barbadosi në vitin 2018. Por, intensiteti i njohjeve filloi të binte që nga viti 2015. Në këtë dhjetëvjeçar Kosovën e njohën vetëm 9 shtete. Vendi

vazhdon të mos njihet nga dy shtete të Ballkanit Perëndimor - Serbia dhe Bosnjë-Hercegovina, si dhe pesë shtete të Bashkimit Evropian - Greqia, Spanja, Rumania, Sllovakia dhe Qiproja. Radio Evropa e Lirë kontaktoi Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe të Diasporës në Kosovë qysh më 10 shkurt për ta pyetur rreth aktiviteteve të saj lobuese, por nuk mori asnjë përgjigje. E cituar nga mediet në Prishtinë, tetorin e kaluar, ministrja e Jashtme, Donika Gërvalla, tha se "njohjet nuk varen vetëm nga Kosova, por edhe nga shumë konstalacione të tjera". Aidan Hehir nga Universiteti Westminster në Londër numëron disa arsye për stagnimin e njohjeve: nën një, shtetet properëndimore

tashmë janë shterur dhe shumica prej tyre e kanë njohur Kosovën dhe, nën dy, vendet që janë të rreshtuara me Rusinë dhe Kinën, ose dashamirëse ndaj Serbisë, nuk mund të binden lehtë.

Hehir thotë se edhe lobimi i Kosovës ka qenë i centralizuar. "Fatkeqësisht, qeveritë e Kosovës që nga viti 2008 kanë qenë shumë, shumë të fiksuara me Shtetet e Bashkuara dhe nuk kanë bërë përpjekje të mjaftueshme për kultivimin e marrëdhënieve me vende jashtë sferës së ndikimit të ShBA-së. Këtu mendoj sidomos në botën arabe, në Lindjen e Mesme, ku janë disa shtete me shumicë myslimane që nuk e njohin ende Kosovën", thotë Hehir për programin "Expose" të Radios Evropa e Lirë.

Hehir pranon se ndikim ka pasur edhe fushata e çnjohjeve e Serbisë. Autoritetet në këtë vend thonë se kanë arritur t'i bindin disa vende për t'i tërhequr njohjet e Kosovës, në mesin e tyre: Surinami, Burundi, Liberia, Ishujt Solomon, Madagaskari, Gana e të tjera, ndonjëse autoritetet në Kosovë nuk konfirmojnë ndonjë çnjohje.

Për ekspertin e marrëdhënieve ndërkombëtare, Hehir, stagnimi në vitet e fundit reflekton, gjithashtu, botën në të cilën jetojmë. "Fuqia po zhvendoset nga Perëndimi drejt Rusisë dhe Kinës. Këto vende kanë tani më shumë ndikim. Ato u ofrojnë vendeve të vogla ndihmë ushtarake ose financiare, duke i kushtëzuar -

ta zëmë - me pesë gjëra, një prej të cilave është anulimi i njohjes së Kosovës". "Në vitet 2008/9/10, Shtetet e Bashkuara u kanë thënë të kundërtën shteteve të vogla: ne do t'ju japim para nëse ju i bëni këto pesë gjëra, përfshirë njohjen e Kosovës. Pra, Kosova goditet fort nga erërat e ndryshimit", thotë Hehir.

Gëzim Krasniqi nga Universiteti i Edinburgut përmend edhe një fakt tjetër shqetësues për Kosovën. Ai thotë se janë disa shtete brenda BE-së që e kanë njohur vendin relativisht herët, por që sot kanë qëndrim skeptik për pavarësinë e tij. "Në radhë të parë mendoj për Hungarinë, një shtet që ka pozicion proserb në raport me anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare. Është shtet që e ka njohur Kosovën, por nuk është shtet që e përkrah avancimin e Kosovës në sferën ndërkombëtare për shkak të raporteve të afërta që i ka zhvilluar me shtetin serb", thotë Krasniqi për "Exposenë". Krasniqi thekson se përtej aspektit numerik të njohjeve, Kosova duhet të kujdeset ta ruajë mbështetjen e shteteve me peshë të madhe ndërkombëtare.

Këtu ai përmend rastin e aplikimit të Kosovës për anëtarësim në Këshillin e Evropës vitin e kaluar, kur i ka pasur numrat, por jo edhe mbështetjen për t'u bërë pjesë e kësaj organizate. "Fatkeqësisht, vitet e fundit kemi parë një ftohje të

raporteve të Kosovës me disa prej aleatëve kryesorë të saj. Të gjithë i kemi dëgjuar deklaratat e zyrtarëve qoftë në ShBA, në Gjermani apo në vende të tjera, që thonë se e kanë të pamundur të angazhohen aktivisht për rritjen e numrit të njohjeve apo anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare për shkak se janë të pakënaqur me hapat që i ka bërë Qeveria e Kosovës në drejtim të zbatimit të Marrëveshjes së Brukselit [për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë]", thotë Krasniqi. Ai thekson se si njohjet ashtu edhe anëtarësimi i Kosovës në organizata ndërkombëtare kalojnë ekskluzivisht përmes normalizimit të marrëdhënieve me Serbinë.

Ky është edhe një kusht që BE-ja i ka vendosur formalisht si Prishtinës ashtu edhe Beogradit nëse duan të përparojnë në rrugën e integritit evropian.

REL-i kontaktoi ministrinë e Jashtme në të pesë shtetet mosnjohëse të BE-së për t'i pyetur nëse janë duke shqyrtuar ndryshimin e pozicionit ndaj Kosovës. Përgjigje mori vetëm prej Ministrisë së Jashtme sllovaqe, e cila tha se ky vend nuk ka ndryshuar qëndrim sa i përket "pavarësisë së njëanshme" të Kosovës.

Krasniqi, ligjërues i Nacionalizmit dhe Sociologjisë Politike, thotë se kushdo që ta formojë Qeverinë e re të Kosovës nuk do të ketë shumë mundësi manovrimi, jashtë

normalizimit të marrëdhënieve me Serbinë. Ai vëren se në Prishtinë, aktualisht, nuk ka disponim të madh për të bërë koncesione në emër të normalizimit por, pavarësisht kësaj, thotë se nuk duhet qëndruar në vendnumërim. "Është me rëndësi që Qeveria e Kosovës t'i shtojë raportet me shtetet njohëse ose mosnjohëse me të cilat ka interesa të përbashkëta, por edhe shkëmbime ekonomike, dhe ta forcojë diplomacinë ekonomike dhe kulturore. Në rrethanat aktuale besoj se ka shumë hapësirë për thellim të bashkëpunimit pa njohje faktike, edhe pse njohja faktike do të ishte shumë e dëshirueshme për Kosovën", thotë Krasniqi.

Edhe Hehir nga Universiteti Westminster thotë se Qeveria e re e Kosovës - kushdo që e formon atë - do të duhet të aktivizohet më shumë, fillimisht duke e paraqitur Kosovën si zgjidhje për konfliktet në Ballkan.

Edhe ambasadat e Kosovës në vendet perëndimore, sipas tij, duhet ta kuptojnë njëherë e mirë se konkurrojnë me ambasadat e Serbisë dhe të jenë më proaktive. "Nëse Kosova vazhdon të mos njihet dhe nëse disa e çnjohin atë, një gjë e tillë do t'i trimërojë nacionalistët serbë, do t'i inkurajojë ata që të vazhdojnë të përpiqen t'i rishikojnë kufijtë e ish-Jugosllavisë jo vetëm në Kosovë, por edhe në Bosnjë". "Ju mund të shihni se në dhjetë vjetet e fundit retorika nga Qeveria e

Serbisë dhe retorika nga Qeveria e Republikës Sërpska brenda Bosnjës është bërë shumë më agresive, shumë më luftarake", thotë Hehir.

Kosova qysh në vitin 2011 është e angazhuar në një dialog për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë, por pak prej marrëveshjeve të arritura janë zbatuar.

Kosova thotë se procesi duhet të përfundojë me njohje reciproke, por Serbia - e cila gëzon mbështetjen e Rusisë në arenën ndërkombëtare - kundërshton. Në 17 vjet të pavarësisë Kosova ka arritur të bëhet pjesë e disa organizatave ndërkombëtare, si Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, por ka dështuar në UNESCO, Interpol e Këshill të Evropës.

Në një intervistë dhënë javën e kaluar televizionit shqiptar "Top Channel", kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka pranuar se në katër vjetet e fundit nuk ka pasur njohje të reja, por ka thënë se ai as që i ka premtuar ato.

E kur Thaçi i ka premtuar 17 vjet më parë, ai ndoshta nuk ka pritur që peizazhi gjeopolitik të ndryshonte në mënyrë dramatike si brenda ashtu edhe jashtë Kosovës. Sot Kosova është nën masa ndëshkuese të BE-së dhe në grindje me aleatët për shkak të tensioneve në veri. Bota, ndërkaq, nuk di ku të godasë më parë - nga luftërat në Ukrainë e Lindje të Mesme e deri te rritja shqetësuese e Kinës.



# REFUZIMI QË PRESIDENTI THAÇI TA VIZITJË BABANË E SËMURË ËSHTË DËNIM SHITESË QË SHKON PËRTEJ KUFIJVE TË DREJTËSISË PENALE



Shkruan: Sali BISLIMI, drejtor i zyrës ligjore First-consulting.ch në Bern dhe Delemont të Zvicrës

Rasti i presidentit Thaçi, në lidhje me mohimin e vizitave për arsye humanitare, ilustron një ndërthurje komplekse ndërmjet ligjit, etikës dhe perceptimit publik.

Ndërsa sistemi i drejtësisë ka për detyrë të garantojë sigurinë dhe të respektojë ligjin, ai nuk duhet të harrojë rëndësinë e dimensionit njerëzor dhe ndikimin e vendimeve në jetën e individëve.

Është e domosdoshme të

adoptohet një qasje që ruan njerëzoren në zbatimin e drejtësisë, duke respektuar normat ligjore që drejtojnë një shoqëri demokratike.

E drejta e të afërmeve për të vizituar, veçanërisht në rrethana të paparashikuara siç është sëmundja e prindit, është një element themelor i të drejtave të njeriut.

Refuzimi i një vizite të tillë është një formë dënimi shtesë që shkon përtej kufijve të

drejtësisë penale.

Sipas ligjit ndërkombëtar, veçanërisht siç përcaktohet në nenin 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare. Refuzimi për t'i lejuar presidentit Thaçi të vizitonte babanë e tij të sëmurë është shkelje e kësaj të drejte, duke ngritur pikëpyetje legjitimiteti lidhur me vendimet gjyqësore në vazhdim.

Nga pikëpamja psikologjike, ndarja nga familja në rrethana të veçanta mund të ketë efekte të rënda në shëndetin e të burgosurve.

Në rastin e presidentit Thaçi, stresi dhe ankthi që lidhet me të pamundurën për të parë një të afërm të sëmurë potencialisht mund të dëmtojë aftësinë e tij për t'u përballur me akuzat kundër tij.

Gjykatës reflektoni nëse nuk jeni robot!

## KOSOVA NËNSHKRUAN KONVENTËN E LUBJANËS-HAGËS PËR HETIMIN E KRIMEVE TË LUFTËS

PRISHTINË, 16 SHKURT - Kosova ka nënshkruar Konventën e Lubjanës-Hagës mbi bashkëpunimin ndërkombëtar në hetimin dhe ndjekjen e krimin të gjenocidit, krimeve kundër njerëzimit, krimeve të luftës dhe krimeve të tjera ndërkombëtare. Konventa u nënshkrua nga ambasadori i Kosovës në Belgjikë, Agron Bajrami, të premtën në ambientet e Ministrisë së Punëve të Jashtme, Tregtisë së Jashtme dhe

Zhvillimit Ndërkombëtar, pas bartjes së kompetencave të plota tek ai nga ministrja në detyrë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Donika Gërvalla.

"Belgjika është shtet depozitar i Konventës së Lubjanës - Hagës mbi bashkëpunimin ndërkombëtar në hetimin dhe ndjekjen e krimin të gjenocidit, krimeve kundër njerëzimit, krimeve të luftës dhe krimeve të tjera ndërkombëtare, ndërsa deri më tash nënshkrimi i saj

është bërë nga më shumë se dyzet shtete të tjera", thuhet në njoftim.

Qëllimi i Konventës së Lubjanës-Hagës është ta lehtësojë bashkëpunimin ndërkombëtar në çështjet penale mes shteteve palë, me synimin për ta forcuar luftën kundër mosndëshkimit për krimin e gjenocidit, krimeve kundër njerëzimit, krimeve të luftës dhe aty ku është e zbatueshme, krimeve të tjera ndërkombëtare.



## EKSPERTI I SIGURISË: IZOLIMI DIPLOMATIK PO RREZIKON SIGURINË KOMBËTARE, KOSOVA DUHET T'I PËRMIRËSOJË MARRËDHËNIET ME SHBA-NË

PRISHTINË, 16 SHKURT - Kosova, që nga shpallja e pavarësisë në vitin 2008, është mbështetur fuqishëm te partnerët ndërkombëtarë, veçanërisht ShBA-ja për ta konsoliduar pozicionin e saj si shtet sovran. Por, eksperti i sigurisë, Drizan Shala, ka ngritur shqetësime serioze për sigurinë e vendit dhe ndikimet gjeopolitike që po shfaqen në rajon, pas alarmit që së fundi u ngrit nga historiani zviceran Oliver Jens Schmitt. "Schmitt së fundmi ngriti një alarm të rëndësishëm për sigurinë e Kosovës, duke paralajmëruar për një rrezik të mundshëm ushtarak. Sipas tij, prioritetet e shtetit duhet të ridimensionohen nga çështjet kulturore drejt përgatitjes serioze për mbrojtje ushtarake, civile dhe infrastrukturale", ka shkruar Shala.

Sipas Shalës, Kosova është përballur me një realitet të ri gjeopolitik, ku duhet të vendosë sigurinë dhe mbrojtjen si



prioritete kryesore. "Niveli i investimeve në siguri dhe mbrojtje duhet të rritet për t'i përballur kërcënimet në rritje", thekson ai.

Shala thekson se në vitet e fundit Kosova ka hasur në një stagnim të dukshëm në arenën ndërkombëtare, ku si pasojë e politikave të gabuara dhe konfrontimeve me aleatët nuk

ka arritur të përfitojë njohje të reja ndërkombëtare dhe ka mbetur jashtë organizatave të rëndësishme si Këshilli i Evropës apo Interpol.

Drizan Shala paralajmëron se ky izolim është një rrezik i madh për sigurinë kombëtare të Kosovës. "Në një kohë kur Rusia dhe Kina po rrisin ndikimin e tyre në Ballkan, ky vakum

dipomatik është një rrezik i madh për sigurinë kombëtare", ka shkruar Shala në "Facebook". Drizan Shala thekson se Kosova duhet të rikthehet në një kurs të qartë të politikës së jashtme, duke ripërtërirë marrëdhëniet e ngushta me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe aleatët evropianë. "Kosova duhet të rikthehet në një politikë të jashtme pragmatike dhe të balancuar. Partneriteti strategjik me ShBA-në duhet të rivalizohet pa vonesë. Historia e Kosovës ka treguar qartë se përkrahja amerikane ishte jetike për ndërhyrjen humanitare të NATO-s, pavarësinë dhe ndërtimin institucional", ka shkruar ai.

Përballë rritjes së tensioneve gjeopolitike dhe kërcënimeve të mundshme nga veriu, Drizan Shala thekson se Kosova duhet t'i rrisë investimet në mbrojtjen kombëtare. "Rritja e kapaciteteve të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) dhe

bashkëpunimi i ngushtë me NATO-n janë të domosdoshme për ta garantuar sigurinë e vendit", thotë ai. Për Shalën është e nevojshme të ekzistojnë plane emergjente për mbrojtjen civile dhe përforcimin e infrastrukturës kritike, si dhe një bashkëpunim i ngushtë me shtetet fqinje të Ballkanit për të ndërtuar një arkitekturë sigurie të përbashkët.

Eksperti i sigurisë thekson se Kosova është përball një udhëkryqi të rëndësishëm dhe, siç thekson Shala, "siguria kombëtare, mbështetja ndërkombëtare dhe zhvillimi ekonomik duhet të jenë themelet e politikave të ardhshme".

Shala i bën thirrje Qeverisë së Kosovës ta kuptojë rëndësinë e përkrahjes ndërkombëtare, duke theksuar se mbështetja e ShBA-së është jetike për të siguruar një të ardhme të qëndrueshme dhe të sigurt për vendin.

# ÇMIMET E LARTA TKURRIN BLERJET

PRISHTINË, 16 SHKURT - Për disa qytetarë të Kosovës çmimet e produkteve ushqimore janë gjithnjë e më pak të përballueshme.

Betim Gashi thotë se mezi arrin të sigurojë gjithçka që duhet për familjen e tij 5-anëtarëshe. "Gjithçka është shtrenjtuar që nga fillimi i luftës në Ukrainë - vaji, mielli, sheqeri e plot produkte të tjera. Ato nuk janë kthyer më në çmime normale, por janë duke u rritur vazhdimisht", thotë 38-vjeçari nga Prishtina.

Ai punon në një institucion shtetëror, ku paga neto është rreth 500 euro, por për shportën mujore thotë se i duhen rreth 400 euro. "Këtu pa e përfshirë rrymën që më kushton rreth 40 euro - plus faturat e tjera, drurët për ngrohje, uji, mbeturinat", thotë Betimi.

Duke folur për Radion Evropa e Lirë, ai tregon se i është dashur ta zvogëlojë sasinë e produkteve higjienike për t'i siguruar të gjitha ushqimet. "Dikur blija detergjent të rrobave prej 9 kilogramësh, tash e marrë nga dy kilogramë", tregon Betimi. E meqë ka fëmijë të vegjël, ai përmend edhe shtrenjtimin e pelenave dhe të pecetave.

Thotë se shpresa e tij e vetme është që shteti të ndërhyjë dhe t'i ulë çmimet e produkteve esenciale, sidomos ato vendore sepse, siç thotë, janë bërë të barabarta me çmimet e produkteve të importuara. Për këtë arsye, Betimi do t'i bashkohet edhe nismës "Kosova bojkoton", përmes së cilës qytetarët janë organizuar në rrjete sociale dhe i kanë ftuar edhe të tjerët që të mos blejnë në dyqanet zinxhirë, më 15 dhe 16 shkurt, në shenjë proteste kundër çmimeve të larta.

Kjo nismë është ndërmarrë fillimisht në Kroaci më 24 janar dhe ka rezultuar me rënie prej më shumë se 50 % të shitjeve në të gjithë vendin. Ajo është përsëritur edhe herë të tjera, jo vetëm në këtë shtet, por edhe në të tjera të Ballkanit Perëndimor.

Gjetiu në botë inflacioni ka marrë hov si pasojë e pandemisë Covid-19 dhe

pushtimit rus të Ukrainës. Vitin 2022 Kosova e ka mbyllur me shkallë mesatare inflacioni gati 12 për qind. Aktualisht është rreth 1 për qind. Por, rënia e inflacionit nuk do të thotë edhe rënie e çmimeve - do të thotë se çmimet rriten më ngadalë.

## Çfarë kërkohet?

Xhevat Kastrati është një ndër nismëtarët e bojkotimit të dyqaneve në Kosovë. Shqetësues për të është fakti se, siç thotë, në shumë shtete të Bashkimit Evropian që i ka vizituar, ka hasur në disa produkte më të lira se në Kosovë. "Shpesh flitet për shtrenjtimin e naftës si faktor për rritjen e çmimeve, me arsyetimin se nafta e shtrenjtuar ka shtrenjtuar edhe transportin e produkteve të importuara. Mirëpo, çmimi i naftës ka rënë, e çmimet e tjera jo. Për më tepër, janë shtrenjtuar edhe çmimet e produkteve vendore", thotë ai. Kërkesat e organizatorëve të bojkotimit për autoritetet e Kosovës janë: zbatimi i ligjeve për mbrojtjen e konsumatorit, ulja afatgjatë e çmimeve konform standardit, përpilimi i ligjit për çmimet tavan dhe kontrollimi i cilësisë së ushqimit.

Radio Evropa e Lirë pyeti Ministrinë e Tregtisë, Ndërmarrësisë dhe Industrisë në lidhje me këto kërkesa, por nuk mori përgjigje.

Një projektligj për çmimet tavan, i hartuar nga Qeveria e Kosovës në vitin 2022, është rrëzuar nga Gjykata Kushtetuese e vendit vitin pasues.

## Pse çmimet në Kosovë janë të larta?

Profesori i Fakultetit Ekonomik në Prishtinë, Arbër Hoti, thotë se, pos luftës në Ukrainë, e cila ka shkaktuar çrregullime në tregje, çmimet në Kosovë i ka rritur edhe importi. Sipas tij, Kosova është shtet i varur nga importi dhe ndikohet dukshëm nga inflacioni global.



"Ajo importon mbi 80 % të mallrave, duke përfshirë ushqime dhe materiale të ndërtimit. Kjo varësi e bën vendin të ndjeshëm ndaj luhatjeve të çmimeve në tregjet ndërkombëtare dhe kostove të transportit", thotë ai.

Kosova prej vitesh përballet me deficit të lartë tregtar.

Të dhënat e siguruar nga Dogana e Kosovës tregojnë se gjatë vitit të kaluar vendi ka importuar mallra në vlerë prej rreth 6.38 miliardë eurosh, ndërsa ka eksportuar vlerën e 889 milionë eurove.

Ky institucion nuk iu përgjigj pyetjes së REL-it se sa dhe cilat produkte ushqimore importohen më së shumti. Por, nga të dhënat e mëhershme, më së shumti importohen mishi dhe produktet e tij, peshku dhe produktet e tij, mjalti, vezët, qumështi e të tjera. Ato, kryesisht, importohen nga Shqipëria, Maqedonia e Veriut,

Gjermania, Italia, Turqia, Kina etj.

Si arsye për çmimet e larta, Hoti përmend edhe politikën fiskale, sipas të cilave, produktet bazë dhe jobazë tatonen njësoj, si dhe mungesa e konkurrencës në treg.

"Për shembull, në sektorin e energjisë elektrike një kompani dominuese furnizon rreth 100 % të konsumatorëve", thotë ai.

## A mund të ulen çmimet?

Skënder Krasniqi nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë e Kosovës thotë se çmimet mund të ulen, por vetëm nëse shteti ndërhyr duke i ndihmuar bizneset vendore me subvencione. Ai thotë se këto biznese detyrohen t'i rrisin çmimet kur materialin për prodhim e blejnë nga jashtë me çmim më të lartë.

Ndër vite, subvencione për bizneset ka pasur.

Në konferencën e fundvitit të kaluar me afaristë, kryeministri i

Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se për tre vjet atyre u ka shpërndarë 1.3 miliard euro në formë të granteve dhe programeve të tjera, për ta forcuar konkurrencën e tyre në tregjet vendore e ndërkombëtare.

Si zgjidhje të mundshme për uljen e çmimeve, Krasniqi sheh edhe uljen e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar për produktet ushqimore. "TVSh-ja në ushqim të ulët nga 18 % në 5%. Pra, do të kishim çmime për 13 % më të ulëta për qytetarët", thotë ai.

Një tjetër zgjidhje do të ishte diversifikimi i furnizuesve, duke shmangur varësinë nga një ose dy shtete kryesore importuese dhe duke kërkuar tregje alternative, thotë Hoti. Këta hapa, sipas tij, do të krijonin konkurrencë më të madhe në import dhe potencialisht çmime më të ulëta.

Hoti thotë se bojkotimi i dyqaneve mund të bëhet shtysë për veprimin e institucioneve - ndikim tjetër nuk pret të ketë.

## Kurti takon ministrin e Financave të Gjermanisë, diskutohet përforcimi i marrëdhënieve tregtare dhe ekonomike



PRISHTINË, 16 SHKURT - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka takuar ministrin e Financave të Gjermanisë, Jörg Kukies, në kuadër të Konferencës së Sigurisë në Mynih. Sipas njoftimit për medie, u bë me dije se Kurti dhe Kukies diskutuan për marrëdhëniet e shkëlqyeshme ndërmjet Kosovës dhe Gjermanisë, përfshirë ato në fushën e sigurisë dhe

mbrojtjes, dhe për mundësitë dhe rëndësinë e shtimit të shkëmbimeve tregtare, investimeve të huaja dhe bashkëpunimit ekonomik. "Gjatë bisedës, kryeministri Kurti veçoi zbatimin e 12 profileve të arsimit dual dhe planet për shtimin edhe të 10 të tjerave për t'i zgjeruar lidhjet ndërmjet shkollimit profesional dhe tregut të punës, përkatësisht arsimit

me ekonominë, rolin e diasporës sonë për forcimin e urave ndërmjet dy vendeve, dhe progresin, ofertën për investitorë të huaj dhe përparësitë e sektorit të teknologjisë në Kosovë", thuhet në njoftim.

Kryeministri shprehu mirënjohje për kontributin dhe mbështetjen e vazhdueshme të Gjermanisë ndaj Republikës së Kosovës.

# Panik në Ukrainë për armëpushimin e propozuar nga Trump! Frikë nga lëshimet dhe premtimet e rreme



Ukraina është në një gjendje paniku, pas njoftimeve të fundit të Donald Trump, i cili foli me Vladimir Putin këtë javë dhe njoftoi ndërmjetësimin e tij për të arritur një armëpushim.

Siç raporton CNN, Ukraina i ka quajtur gjithmonë zonat nën kontrollin rus "territore të pushtuara përkohësisht" dhe këmbënguli se do t'i rimarrë ato.

Megjithatë, presidenti amerikan tha se nuk ka gjasë që Ukraina të rimarrë pjesën më të madhe të territorit të saj të pushtuar në negociatat e paqes që ai synon të mbajë me presidentin rus Vladimir Putin.

Komenti i Donald Trump erdhi pas një telefonate 90-minutëshe me homologun e tij rus.

Pak në Ukrainë besojnë se Trump do të negociojë me mirëbesim.

## Ata dyshojnë se Putini dëshiron paqe

Yuliya Kazdobina, një eksperte e politikës së jashtme në

institutin ukrainas Prism, i tha CNN se ajo nuk beson se lideri rus dëshiron paqen.

Eksperti thotë se Rusia ka një rekord të shkeljes së marrëveshjeve me Ukrainën për dekada.

"Në vitin 1994, Ukraina ra dakord të heqë dorë nga armët e saj bërthamore në këmbim të garancive nga Shtetet e Bashkuara, Mbretëria e Bashkuar dhe Rusia se do të respektonin sovranitetin dhe integritetin territorial të Ukrainës. Në vitin 2015, pas aneksimit të paligjshëm të Krimesë dhe ndezjes së konfliktit në Ukrainën lindore, Moska nënshkroi një marrëveshje armëpushimi, vetëm për ta shkelur atë në mënyrë të përsëritur dhe më pas filloi një pushtim në shkallë të plotë të Ukrainës shtatë vjet më vonë", tha ajo.

Kazdobina i tha CNN se Rusia është me dy fytyra: "Kur bëhet fjalë për të bërë lëshime dhe për të bërë paqe, nuk e bën kurrë."

Pas njoftimit të telefonatës Trump-Putin, presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky

theksoi se vendi i tij nuk do të pranonte një marrëveshje paqeje që SHBA-të do të lidhnin me Rusinë pa pjesëmarrjen e Kievit.

"Si vend i pavarur, ne thjesht nuk mund të pranojmë asnjë marrëveshje pa ne. Dhe këtë ua bëj shumë të qartë partnerëve tanë. Ne nuk do të pranojmë asnjë negociatë dypalëshe për Ukrainën pa ne", tha ai dhe pranoi se fakti që Donald Trump foli fillimisht me Vladimir Putinin nuk ishte "i këndshëm".

Edhe ukrainasit kanë pikëpamje të ngjashme. Studenti Nazar Voloshenko tha se çdo bisedë që mund të çojë në humbjen e territoreve shtesë do të ishte katastrofike për vendin.

"Ne mund të mbetemi pa territoret e pushtuara përkohësisht, pa pjesë të rajonit Kherson, rajonit të Zaporizhia dhe Krimesë së shumëvujtur", tha ai.

"Ne duhet të marrim atë që me të drejtë është e jona", tha ai.

Forcat ruse tani mbajnë pothuajse 20% të territorit të Ukrainës, nga afërsisht 7% që

kontrollonin para pushtimit. Vlerësohet gjithashtu se rreth 6 milionë njerëz, përfshirë 1 milionë fëmijë, jetojnë nën pushtimin rus, në një situatë që Kombet e Bashkuara e kanë cilësuar si "të mjerë për të drejtat e njeriut", pasi opozita është e shtypur, ndërsa ka akuza për shënjestrimin e komuniteteve apo individëve që Moska i konsideron si pengesë për procesin e rusifikimit.

Këshilltari ekonomik Oleksandr Sokhatskyi tha për CNN se ai beson se çdo marrëveshje do të ishte e papranueshme nëse kufijtë e Ukrainës ndryshojnë nga ato që ishin para luftës, duke marrë parasysh koston njerëzore.

"Duke pasur parasysh sa viktima ka pasur tashmë kjo luftë dhe që ajo të përfundojë me kushtet e dikujt tjetër... atëherë pse vdiqën ata (ushtarët ukrainas) dhe pse i mbrojtën këto toka?"

Ushtria, të cilët janë në vijën e parë të frontit, janë gjithashtu të kujdesshëm për rezultatet e një negociatimi të Donald Trump. Komandanti i

batalionit të Brigadës 66 të Mekanizuar paralajmëroi për pasoja të rrezikshme.

"Ajo do të krijojë një precedent dhe do t'i tregojë Rosisë se mund të sulmojë çdo vend, të pushtojë territorin e tij dhe ta bëjë atë të vetin pa u ndëshkuar në të ardhmen," tha ai, duke shtuar se Rusia së shpejti mund ta kthejë vëmendjen e saj drejt vendeve të tjera më të vogla afër saj.

Putini i ka bërë vazhdimisht të qarta qëllimet e tij: Ai dëshiron të fitojë kontrollin e të gjitha rajoneve lindore të Ukrainës Donetsk dhe Luhansk. Por shumë në Ukrainë shqetësohen se, edhe nëse ai fillimisht bie dakord për një armëpushim, ai përfundimisht do të nxisë luftime të mëtejshme për të arritur qëllimin e tij.

"Askush dhe asgjë nuk do ta ndalojë Putinin të na sulmojë përsëri dhe të pushtojë një ose më shumë rajone. Nëse Evropa dhe Amerika nuk na ndihmojnë, atëherë vendosja e paqes tani ka të ngjarë të çojë në luftë pas disa vitesh", tha Sablyn.



# ‘Miliarda dollarë investime’, Ukraina dhe SHBA marrëveshje për mineralet e rralla



Rezervat e mëdha me minerale të rralla i japin Ukrainës mundësitë për të qenë një furnizues strategjik për Perëndimin. Presidenti Donald Trump po shqyrton një marrëveshje që do të sigurote vazhdimin e mbështetjes amerikane për Ukrainën në luftën kundër Rusisë në këmbim të qasjet tek mineralet e saj.

Sic njoftojnë korrespondentet e Zërit të Amerikës, Myroslava Gongadze nga Varshava, dhe Anna Chernikova nga Kievi, ky propozim po diskutohet gjatë Konferencës së Sigurisë në Muni.

Miniera Zavallivsky në Ukrainën qendrore ka një nga depozitat më të mëdha të grafinës në Evropë, një material kyç për bateritë e automjeteve elektrike dhe reaktorët bërthamorë.

Kjo është një nga rezervat e

mëdha të mineraleve të rralla që synojnë Shtetet e Bashkuara ndërsa përpiqen të ulin varësinë nga Kina për materiale të tilla.

Drejtimesit e minierës thonë se me investimet e duhura ajo mund të bëhet një lojtare globale në sektorin e grafinës. “Bëhet fjalë për miliarda dollarë dhe vite investime. Qeveria ukrainase duhet të punojë ngushtë me partnerët amerikanë, evropianë dhe lojtarë të fuqishëm në mbarë botën për të bërë një lëvizje në këtë proces, për ta krijuar këtë bazë së bashku”, thotë Ostap Kostyuk, drejtues i minierës së grafinës, Zavallivsky.

Qeveria ukrainase thotë se vendi i saj ka depozita minerale të 22 nga 50 materialet strategjike të identifikuar si kritike nga Shtetet e Bashkuara. Po ashtu ka 25 nga 34 mineralet që

Bashkimi Evropian i ka klasifikuar si tejet të rëndësishme.

Bëhet fjalë për grafinë, litium, titanium dhe uranium, minerale thelbësore për industrinë e mbrojtjes, energjinë e gjelbër dhe industrinë e teknologjisë së lartë.

Ekspertët thonë se Ukraina ka potencial të lartë por kërkohen investime të mëdha për t’i shfrytëzuar këto rezerva. Zëri i Amerikës bisedoi me zonjën Mariia Kurylo, e cila është me Komisionin Shtetëror për Burimet Minerale.

“Projektet për mineralet e rralla jo vetëm që janë shumë të rëndësishme, por janë strategjike për zhvillimin, jo vetëm për partnerët perëndimorë por edhe për zhvillimin tonë”.

Kompania ukrainase BGV, e

cila investon në miniera, thotë se ka shpenzuar 100 milionë dollarë në projekte të mineraleve kritike, por për të rritur operacionet kërkohen investime shtesë prej qindra miliona dollarësh.

Zëri i Amerikës bisedoi me Serhii Voitsehovskyin, anëtar bordi i kompanisë ukrainase të investimeve minerare, BGV. “Zhvillimi i minierës së grafinës në Balakhivka kërkon investim kapitali prej rreth 450 milionë dollarësh”.

Ndërsa Amerika dhe vendet e tjera perëndimore kërkojnë të ulin varësinë nga Kina për minerale kritike, Ukraina sheh një mundësi për të forcuar ekonominë dhe sigurinë e saj. “Kemi një strategji që sjell përfitime në çdo aspekt. Partnerët kanë nevojë për këto materiale, që në të vërtetë janë produkte me vlerë të lartë”, thotë Serhii

Voitsehovskyi me firmën BGV. Amerika dhe Evropa janë përpjekur të ulin varësinë e tyre nga Kina, furnizuesi kryesor në botë me minerale të rralla. Roman Opimakh ka qenë drejtor i përgjithshëm i Shërbimit Gjeologjik të Ukrainës.

“Ukraina do të ndihmojë Evropën dhe Amerikën për të ulur varësinë nga Kina dhe pjesërisht nga Rusia. Në të njëjtën kohë forcon qëndrueshmërinë në vend. Investimet e shumta dhe furnizimet e larta mund të funksionojnë si një kupolë e hekurt për Ukrainën”.

Ai thotë se partneriteti është strategjik dhe ekonomik. Pavarësisht luftës dhe humbjeve të mundshme të territoreve, ai thotë se shumica e mineraleve kritike mbeten nën kontrollin e Kievit./VOA

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



# FC Kosova Düsseldorf merr kreun e tabelës në Landesliga

Ekipi shqiptar në Gjermani 'FC Kosova Düsseldorf', ka arritur fitore të madhe duke mposhtur ekipin rival SG Unterrath me rezultat 2-0. Golat për ekipin lider në Landesliga i shënuan Astrit Hyseni (40') dhe Fatlum Ahmeti (90'+3'). Me këtë fitore FC Kosova Düsseldorf ngjitet në krye të tabelës.

**TABELA AKTUALE E LANDESLIGA NIEDERRHEIN GRUPPE 1**

**1. FC KOSOVA DÜSSELDORF - 45 PIKË (20 NDESHJE)**

**14 FITORE | 3 BARAZIME | 3 HUMBJE  
54 GOLA TË SHËNUAR | 18 GOLA TË PRANUAR**

**SULMI MË I MIRË NË LIGË  
MBROJTJA MË E MIRË NË LIGË**

**TABELLE**  
LANDESLIGA NIEDERRHEIN

**SPIELTAG 16**

	SP	TV	TD	P
<b>1. FC KOSOVA</b>	<b>20</b>	<b>54:18</b>	<b>36</b>	<b>45</b>
2. VFL JÜCHEN	20	49:20	29	45
3. FC REMSCHEID	20	41:22	19	42
4. HOLZHEIM	20	45:29	16	39
5. ASV SUCHTELN	20	50:33	17	37
6. VFB HILDEN 03 II	20	46:29	17	33

16.02.2025



## Gjilani mposhti kampionin, Llapi rikthehet te fitorja

**GJILAN, 16 SHKURT** - Dy ndeshjet e së dielës në kuadër të javës së 20-të në AlbiMall Superligën e Kosovës kanë dhuruar emocione të mëdha, ku Gjilani dhe Llapi kanë shënuar fitore të rëndësishme. Gjilani ka triumfuar para tifozëve të vet me rezultat 2:1 ndaj kampionit në fuqi, Ballkanit, falë dy golave të sulmuesit boshnjak, Senad Jarović. Ballkani kaloi në epërsi në minutën e 41-të me golin e Bleart Tolajt, por Gjilani reagoi fuqishëm në

pjesën e dytë. Jarović fillimisht barazoi shifrat në minutën e 64-t, ndërsa golin e fitores e realizoi në minutën e 94-t, duke i dhënë skuadrës së tij një fitore të madhe pas një periudhe të gjatë pa triumf ndaj Ballkanit. Me këtë fitore, Gjilani është ngritur në vendin e pestë me 27 pikë, ndërkohë që Ballkani mbetet në garën për titull, duke qenë në vendin e dytë me 36 pikë, tetë më pak se liderja Drita. Në ndeshjen tjetër, Llapi i ka dhënë fund



serisë prej 12 ndeshjeve pa fitore në Superligë, duke mposhtur në udhëtim Feronikelin 74, me rezultat

bindës 3:0. Valmir Veliu ishte protagonist kryesor i ndeshjes, duke realizuar dy gola, në minutat 10 dhe 66, ndërsa një autogol i Armend Halilit në minutën e 60-të e vulosi rezultatin përfundimtar. Pavarësisht fitores, Llapi mbetet në pozitën e parafundit me 21 pikë, ndërsa Feronikeli 74 vazhdon të mbajë vendin e fundit me 10 pikë. Ndeshja e fundit e javës së 20-të zhvillohet të martën, ku takohen Malisheva dhe Ferizaj.

## Rahoveci i pandalshëm, fitore të rëndësishme për Trepçën e Vushtrrinë



**PRISHTINË, 16 SHKURT** - Rahoveci ka vazhduar me fitore në Superligën e Kosovës në hendboll. Të dielën mbrëma në kryeqytet, Rahoveci e mposhti Prishtinën me rezultat 37:31. Rahoveci ishte vendas në ndeshjen e xhiros së 17-të, por sfida megjithatë u zhvillua në Prishtinë për shkak se palestra në Rahovec është e zënë me numërimin e votave. Rahoveci ka 17 fitore dhe udhëheq në tabelë me 34

pikë. Prishtina renditet e katërta me 17 pikë. Egzon Gjuka i shënoi 13 gola për "vreshtarët", derisa nga pesë i shtuan Mali Luzha e Jon Muqolli. Nga tetë gola te Prishtina i kishin Oltion Beshiri e Albi Gjuka, ndërsa gjashtë i realizoi Erion Bajramaj. Dy ndeshjet tjera të së dielës kishin peshë në garën për mbijetesë. Trepça e shënoi fitoren e tretë rresht. E mposhti Llapin në Samadrexhë me rezultat

36:31. Arbër Neziri i shënoi 10 gola për "xehtarët", ndërsa nëntë i kishte Ermir Smaka. Blerton Hasani realizoi shtatë gola për llapjanët, derisa pesë i kishte Rifat Visoka. Trepça mbetet e fundit, por tani i ka gjashtë pikë, vetëm dy më pak se Vjosa. Llapi është i gjashti me nëntë pikë. Fitoren më të thellë të xhiros e shënoi Vushtrria. Në Shtime e mposhti Vjosën me rezultat 63:14. Me fitore Vushtrria doli në vendin e pestë me 10 pikë.

## Khaka: Barazimi ndaj Bayernit, ishte si një humbje për ne

**LEVERKUSEN, 16 SHKURT** - Bayer Leverkusen dhe Bayern Munich nuk shkuan më shumë se një barazim ditën e djeshme në "BayArena". Granit Khaka u shfaq i dëshpëruar pas këtij takimi edhe pse në

fjalët e tij tregoi se ishte krenar për performancën e ekipit në fuqi të Bundesligës. "Mendoj se ky barazim ka një shije humbjeje. Ne arritëm që të jepnim gjithçka që kishim, por pa

mundur që të merrnim atë që donim. Trajneri ka të drejtë, por sezoni nuk ka mbaruar ende dhe kemi ende shumë sfida përpara. Ne do të vazhdojmë të luajmë ashtu siç kemi bërë edhe vjet kur ishim

20 pikë përpara. Për ne nuk ka asnjë dallim. Nëse në fund të kampionatit Bayerni i Mynihut do të ketë më shumë pikë se sa ne atëherë do të japim dorën për të uruar për titullin", ka thënë Granit Khaka.



## Taulant Xhaka zbulon ëndrrën që dëshiron ta realizojë bashkë me vëllanë, Granitin

**BASEL, 14 SHKURT** - Skuadra zvicerane FC Basel humbi një legjendë. Taulant Xhaka e mbyll karrierën në verë. Arsyet dhe planet e tij për të ardhmen janë me vëllanë Granit Xhaka. Ëndrra e tij e madhe si futbollit nuk u realizua, të luajë sërish për

FC Baselin me vëllanë. Kjo nuk ishte vetëm ëndrra e Taulantit, ishte edhe e Granitit. Dhe kjo ishte ëndrra e shumë tifozëve të FCB. "Sigurisht që jam i trishtuar. Ishte një ëndërr e imja, por jam i lumtur që tani filloj një kapitull të ri,

atë të punës së trajnerit. Ndoshta një ditë do të punojmë me Granitin si trajner në FC Basel, unë si ndihmëstrajner i tij", ka thënë Xhaka për mediumin zviceran "90min". Nga njëra anë është licenca e trajnerit dhe ëndrra për të qenë

dyshe trajnerësh me vëllanë Granitin, por edhe Xhaka thotë se mezi pret të kalojë kohë me familjen dhe fëmijët. "FC Basel më ofroi mundësinë për të qëndruar në klub, por kam nevojë për distancë", ka shtuar Xhaka.



## Di Maria: Messi është 'fajtori' pse Ronaldo nuk është më i miri

**LISBONË, 14 SHKURT** - Angel Di Maria ka dhënë një intervistë për "Infobae" për ta parë karrierën dhe sukseset e tij me kombëtaren argentinase. "El Fideo" gjithashtu u pyet drejtpërdrejt për mendimin e tij për fjalët e Cristiano Ronaldos në intervistën e tij në "LaSexta", në të cilën ai pretendonte se ishte lojtari më i mirë në histori. Ylli argentinase ka shpërfillur ish-bashkëlojtarin e tij te Real Madridi, Ronaldon, për ta vlerësuar më



lart bashkëkombësin e tij, Lionel Messin. "Unë tashmë e njoh atë, kam qenë me të për katër vjet. Nuk jam i befusuar nga deklaratat e Cristianos. Ai gjithmonë i bënte ato deklaratat. Ai donte të impononte atë që donte të ishte. Atë që gjithmonë u përpoq të ishte. Të ishte më i miri", ka thënë fillimisht Di Maria.

"Ai lindi në një gjeneratë... në një kohë të keqe kur lindi një tjetër që u prek nga shkopi magjik dhe ja ku është ai, xhuxhi është këtu, ky është realiteti. Kjo tregon në shifra, tregon në gjithçka". "Njëri ka tetë Topa të Artë, pesë tjetri, ka një ndryshim

shumë të madh me një kampion tjetër, ka edhe një tjetër Kupën e Botës. Ka shumë dallime, shumë dhe më pas, a më kuptoni në çdo minutë të lojës që njëri bën përpjekje në çdo gjë dhe tjetri luan sikur të ishte në oborrin e shtëpisë. Të gjithë e dinë se çfarë do të bëjë Leo dhe ai arrin të njëjtin qëllim si gjithmonë dhe vazhdon ta bëjë atë. Ai ka bërë të njëjtin gjë për 18 ose 20 vjet dhe të gjithë thonë 'ti e di se çfarë do të bëjë'. Epo, markoje nëse e di se çfarë do të bëjë. Dhe ai bën të njëjtin gjë", ka shtuar Di Maria. "Dhe ai do të jetë ende i tillë në moshën 40-vjeçare, por edhe Cris është i tillë, ai gjithmonë ka qenë i njëjti. Për mua Leo është

më i miri në botë dhe më i miri në histori padyshim dhe pastaj jemi te Benfica dhe ai (Cristiano) është nga rivalët", ka përfunduar kampioni i botës me Argentinën.

Di Maria është një nga lojtarët që mund të mburret se ka luajtur me Ronaldon, me të cilin përkoi për katër sezone në Real Madrid, dhe Messin, me të cilin ka luajtur në kombëtaren argentinase dhe, gjithashtu, në Paris Saint-Germain. Së bashku me Cristianon ai fitoi dy Copa del Rey, një La Liga dhe një Ligë të Kampionëve, ndërsa me Messin ai ka fituar një Kupë Bote, dy Copa America, si dhe një Ligë 1.

### SHKURT

#### Deschamps: Zidane, kandidat natyral për trajner të Francës

Trajneri Didier Deschamps, i cili do të largohet nga Franca në fund të Botërorit 2026, në intervistën e tij për "L'Equipe" u pyet edhe në lidhje me Zinedine Zidanin që shihet si pasardhës i tij. "Kemi shumë respekt mes nesh. Zizu është një kandidat optimal, një kandidat natyral. Të jem i sinqertë, nuk e di nëse e dëshiron këtë post. Vendimi do të jetë i tij dhe i presidentit", ka thënë Deschamps.

#### Djali i Mançinit: Yamal do të bëhet më i mirë se Messi

Andrea Mançini, i biri i trajnerit Roberto Mancini, punon si skaut te Barcelona. Ai pranoi ofertën e katalanasve në verën e kaluar për shkak të lidhjeve të forta që ka me drejtorin sportiv Deco dhe të birin e presidentit Laporta. "Ishte një mundësi unike për mua. Më kuptoni, ishte e pamundur të refuzoja. Kishim disa vjet kontakt. Unë e njoh mirë djalin e Laportës dhe projekti më interesoi menjëherë. Deco kishte nevojë për një person në mes të Italisë dhe Spanjës. Më zgjodhi mua dhe jam i lumtur për këtë. Barcelona po fokusohet më shumë tek akademia. Objektivi im është të gjej se ku është Lamine Yamal i ri. Sfidat e klubit është të marrë të paktën katër ose pesë lojtarë të rinj nga La Masia në ekipin e parë çdo vit. Sipas meje, Yamal do të bëhet më i mirë se Messi", ka thënë skauti i Barcelonës.

#### Piastrri: Jemi të barabartë te McLarenit, edhe unë kandidat për titull

Pati mjaft polemika gjatë vitit të kaluar rreth urdhrave të ekipit në McLaren, me synimin për të favorizuar Lando Norrisin në ndjekjen e titullit kampion bote për pilotë, në duelin kundër Max Verstappenit. Ai që ka vuajtur këto urdhra është piloti tjetër i McLarenit, Oscar Piastrri, që këtë sezon ngre zërin. Në fillim të kampionatit botëror 2025 të Formulës 1, te McLarenit nuk kanë ndër mend të planifikojnë një pilot të përcaktuar të parë dhe të dytë. Pasi mbërriti në McLaren në moshën 22-vjeçare, Oscar Piastrri, pas dy sezonesh mendon se është kandidat për të qenë në mesin e protagonistëve. Australiani arriti dy fitore dhe një pole position vitin e kaluar, por ai tha se ka synime edhe më ambicioze. "Dua ta fitoj kampionatin botëror këtë vit dhe shpresoj se do të kemi një makinë të aftë për ta bërë këtë që në fillim. Ne do të garojmë lirshëm nga fillimi i vitit. Të gjithë e nisim nga e para", ka thënë Piastrri. Ai shtoi se nuk ka ndër mend të bëjë asnjë lëshim për shokun e tij të skuadrës Lando Norris: "Ne treguam se jemi të aftë të luftojmë njëri-tjetrin fort, por pastër. Për sa kohë që nuk e bëjmë skuadrën të humbasë pikë, gjithçka do të jetë mirë. Ne jemi dy pilotë të aftë për të fituar".

## Curry i jep fitoren Golden States, triumfojnë edhe clippersat, Minnesota e Dallasi

**HOUSTON, 14 SHKURT** - Oklahoma, skuadra që kryeson renditjen në Perëndim, u mund me rezultat 116-101 në fushën e Minnesotas. Naz Reid me 27 pikë e 14 rebounde ishte shënuesi më i mirë për vendësit, mbështetur edhe nga Anthony Edwards me 23 pikë. Fitore të rëndësishme jashtë fushës korri Golden State, që falë 27 pikëve të Stephen Curryt, mundi me rezultat 105-98 Houstonin. Skuadra e Clippersit korr fitoren e dytë radhazi në 24 orë, duke mundur me shifrat 120-116



Utah Jazzin, takim ku u dallua James Hardeni me 32 pikë. Në një ndeshje spektakolare, ekipi i New Orleansit mposhti me

### REZULTATET

New Orleans - Sacramento	140-133
Houston - Golden State	98-105
Minnesota - Oklahoma	116-101
Dallas - Miami	118-113
Utah Jazz - Clippers	116-120

shifrat 140-133 Sacramenton. CJ McCollum realizoi 43 pikë për vendësit. Fitoi edhe skuadra e Dallasis, që mundi me rezultat 118-113 Miamin, sfidë ku 7 lojtarë të ekipit teksan realizuan mbi 10 pikë.

## Katari kërcënon se do t'i tërheqë investimet për klubin e PSG-së

Zyrtarët e Katarit kërcënojnë se do t'i tërheqin investimet në klubin francez të Paris Saint-Germainit. Qatar Sports Investments bleu parisienët në vitin 2011 dhe Nasser Al-Khelaifi u emërua president i

klubit. Që nga ajo kohë PSG ka shënuar periudhën më të suksesshme në historinë e tij, duke fituar 10 tituj të Ligës 1 në 12 sezonet e fundit. Por sipas "Agence France Presse", Al-Khelaifi u akuzua në fillim të

muajit për bashkëpunim në blerjen e votave, "ndërhijje në lirinë e votimit" dhe "përfshirje në abuzimin e pushtetit". Vetë numri 1 i klubit parisien i ka mohuar akuzat. Çështja në fjalë ka të bëjë me biznesmenin

francez Arnaud Lagardère dhe një përpjekje të dyshuar për të ndikuar në një votim nga "Fondi Sovran i Katarit", te aksionari në grupin e tij. Katari u është përgjigjur akuzave të ngritura kundër Al-Khelaifit

duke kërcënuar se do t'i ndalojë investimet në Francë. Përveç klubit parisien, mund të preket edhe rrjeti i kanaleve sportive BeIn Sports. Sipas medieve franceze, në Katar janë lodhur me të tillë abuzim.



### KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "PASTRIMI" SH.A.

Bazuar në Ligjin e Punës Nr. 03/L-212, konkretisht Neni 8, në Rregulloren nr. 07/2024 për Marrëdhënien e Punës në KRM "Pastrimi" Sh.A. konkretisht Nenin 11 dhe 12, në Rregulloren Nr. 01/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në KRM "Pastrimi" SH.A, në Vendimin e datës 14/02/2025 me numër të protokollit 06/03/548 të Kryeshefit Ekzekutiv të KRM "Pastrimi" SH.A, shpallë këtë:

#### KONKURS PUBLIK Për plotësimin e vendit të punës

Titulli i vendit të Punës: **Kryepunëtori i Higjienës Publike në Njësinë Operative në Prishtinë** në KRM "Pastrimi" SH.A (1) pozitë;

Departamenti: **Drejtoria e Operativës;**

Numri i Referencës: **DO/KJ-08/2025;**

Koeficienti/Paga mujore: **Niveli XI;**

Kohëzgjatja e Kontratës së Punës: **Me kohë të pa caktuar.**

Periudha Provuere: **3 muaj**

#### Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Organizon, përcjellë dhe kontrollon realizimin e punëve të përcaktuara me urdhëresë të punës lidhur me mirëmbajtjen dhe pastrimin të rrugëve dhe sipërfaqeve tjera të përcaktuara në plan Operativ;
- Kontrollon punëtorët e higjienës publike lidhur me përbushjen e obligimeve që kanë dhe raporton për cdo parregullsi apo pengesë gjatë punës;
- Në rastet kur për arsye objektive, punëtori i higjienës nuk e përbushë detyrën e pranuar, të njëjtit i referon zonën tjetër për pastrim sipas planit operativ;
- Në rastet aksidenti apo pengese në mbarëvajtjen e punës, merr pjesë dhe sheh nga afër gjendjen e punëtorëve të higjienës;
- Kryen edhe punë të tjera që kërkohen nga Udhëheqësi;
- Për punën e tij i përgjigjet Udhëheqësit të njësisë së higjienës publike.

#### 2. Kriteret e përgjithshme për praninë në detyre:

- ✓ Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- ✓ Të ketë zotësi të plotë për veprim, sipas legjisllacionit në fuqi;
- ✓ Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- ✓ Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- ✓ Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e një veprës penale;
- ✓ Të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkua për pozitën;
- ✓ Të kalojë me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë ligj.

#### 3. Kërkesat e përgjithshme formale

- ✓ Arsimimi i kërkuar: Diplomë universitare apo Shkollim i mesëm;
- ✓ Përvoja e punës e kërkuar: 2 vite përvojë pune në fushën përkatëse

#### 4. Njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkua në procedurën e rekrutimit

- ✓ Aftësi të arsyetimit logjik dhe analizës;
- ✓ Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësi për të përfaqësuar;
- ✓ Shkathtësi hulumtuuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- ✓ Aftësi për të bërë gjykime profesionale të pavarura dhe për të ushtruar diskrecion mbi çështjet dhe për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe zbatimin e politikave;
- ✓ Njohuri të gjera të fushës, të metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike;

#### 5. Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre

- ✓ Aplikacioni i plotësuar dhe nënshkruar nga kandidati;
- ✓ Kopje të diplomave të dhëna nga Institucionet Arsimore;
- ✓ Kopje të dëshmisë së punësimit ( Trusti Pensional, Vërtetimi, apo Kontratë të Punës);
- ✓ Kopje të dëshmisë së trajnimeve dhe kurseve;
- ✓ Kopje të vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit, (e dëshirueshme);
- ✓ Kopje të letërnjoftimit;
- ✓ Vërtetimin që nuk është i dënuar për kryerjen e një veprës penale jo më të vjetër se 3 muaj.

#### 6. Mënyra e aplikimit në konkurs:

Kandidatët e interesuar, formularin zyrtar mund ta marrin në Zyrat e Burimeve Njerëzore në KRM "Pastrimi" SH.A.

Të gjitha aplikimet duhet të bëhet vetëm në mënyrë elektronike nëpërmjet platformës elektronike: [punesimi.krmpastrimi@gmail.com](mailto:punesimi.krmpastrimi@gmail.com)

#### 7. Data dhe ora e saktë e përmbylljes së Konkursit Publik:

Konkursi publik zgjatë 15 ditë nga data: 17.02.2025 deri me datën 04.03.2025. Koha e fundit e pranimit të aplikimeve është ora 16:00.

Të gjitha aplikimet që arrijnë pas afatit të fundit nuk do të merren parasysh.

#### 8. Mënyra e vlerësimit dhe kriteret e poentimit:

Vlerësimi i kandidatëve bëhet në bazë të CV-së, testit me shkrim dhe me intervistim (test verbal).

- ✓ CV-ja e kandidatit vlerësohet deri në dhjetë (10) pikë;
- ✓ Testi me shkrim vlerësohet deri në shtatëdhjetë (70) pikë;
- ✓ Intervista (testi me gojë) vlerësohet deri në njëzetë (20) pikë.

Procedura e vlerësimit përmban gjithsejtë njëqind (100) pikë, ku kalueshmëria është arritja e së paku pesëdhjetë e pesë (55) pikëve nga të gjitha fazat e Konkursit Publik.

#### 9. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët:

Të gjithë kandidatët do të njoftohen nëpërmjet komunikimit elektronik dhe individualisht.

#### 10. Kalendar i përafërt i procedurës së rekrutimit:

Konkursi është i hapur deri me datën 04.03.2025.

Faza e verifikimit paraprak të aplikacioneve deri 7 ditë;

Faza e testit me shkrim deri 10 ditë pas fazës së verifikimit;

Faza e Intervistës deri 7 ditë pas shpalljes së rezultateve të testit me shkrim;

Publikimi i rezultateve deri 5 ditë pas vlerësimit të intervistë.

**Vërejtje:** Dokumentet e pa kompletuara, të pa skanuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.



Adresa: rr.Ibrahim Krasniqi Prishtinë [lurnshpk@gmail.com](mailto:lurnshpk@gmail.com) Nr tel: 045510011&46  
143401&45 690 141

Prishtinë, 13.02.2025

### NJOFTIM PUBLIK

Shoqëria „LURN“ SH.P.K., me numër Unik Identifikues 810084062 me adresë: Rr. „Ibrahim Krasniqi“ nr. 10, Komuna e Prishtinës Republika e Kosovës, në përputhje me dispozitat e Nenit 13 të Rregullës Nr. 03/2022 për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Projekteve të Energjisë, me datë 13.01.2025 ka dorëzuar në Zyrën e Rregullatorit për Energji (ZRRE) aplikacionin për marrje të Autorizimit dhe për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga panelet solare me kapacitet të instaluar prej **483.12 kW** ZK Shajkoc, Komuna e Podujevës, Republika e Kosovës.

Shoqëria „LURN“ SH.P.K., për projektin solar me kapacitet të instaluar prej **483.12 kW** ZK Shajkoc, Komuna e Podujevës, me rastin e aplikimit, ka dorëzuar në ZRRE dëshmitë për marrje të AUTORIZIMIT siç janë:

- Pëlqimin Mjedisor Nr.3861-2/23 dt. 23.10.2023 të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.
- Njoftimi nr. 07-350/02-0032027/23 dt. 10.05.2023 të lëshuar nga Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Podujevës.
- Vendimi për Kushte Ndërtimore Nr. 07-0350/04-0085583/23 dt. 12.02.2024 të lëshuar nga Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Podujevës.
- Vendimin për Leje Ndërtimore Numri i vrojtimit të lejes: Nr. 07-351/02-0044941/24 të datës 29.11.2024 për "Ndërtimin e Parkut të Energjisë Solare Fotovoltaike me kapacitet prej 483.12 kW, ZK Shajkoc, të lëshuar nga Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Podujevës.
- Pëlqimin Elektroenergjetik Nr. 19358 dt.20.10.2024 të lëshuar nga KEDS SH.A.
- Dëshmi mbi të drejtat pronësore (Kontratat për shfrytëzimin e tokës);
- Deklaratën për shitjen e energjisë;
- Deklarimet financiare;
- Dëshmi për posedimin e 10% të vlerës së investimit
- Kontratën për Inxhinieri, Prokurim dhe ndërtim (EPC)
- Plani i Biznesit; dhe
- Plani Dinamik i Realizimit.

Aplikuesi ka dorëzuar edhe kërkesat administrative sipas aplikacionit dhe ka dorëzuar deklaratën që, energjia e prodhuar nga ky projekt do të shitet bazuar në çmimet e tregut. Njoftohen të gjitha palët e interesuara që vërejtjet e tyre eventuale lidhur me këtë aplikacion, mund të paraqesin në ZRRE brenda 8 (tetë) ditësh nga data e publikimit të këtij njoftimi në adresën elektronike: [lurnshpk@gmail.com](mailto:lurnshpk@gmail.com) dhe [LEGAL-LEECENSING@ero-ks.org](mailto:LEGAL-LEECENSING@ero-ks.org) Qasja në dosjen e Aplikimit, për të cilat Aplikuesi ka lejuar qasje, mundësohet për aq sa e lejon legjisllacioni për Qasje në Dokumentet Publike.



### REGIONALNO PREDUZEĆE ZA OTPAD "PASTRIMI" SH. A

Na osnovu Zakona o radu br. 03/L-212, tačnije člana 8., u Uredbi br. 07/2024 o radnom odnosu u KRM "PASTRIMI" Sh.A. Konkretno, član 11 i 12, u Uredbi br. 01/2024 o unutrašnjoj organizaciji i sistematizaciji radnih mesta u RM "PASTRIMI" SH. A, u Odluci od 14/02/2025 sa brojem protokola 06/03/548 glavnog izvršnog direktora RM "PASTRIMI" SH. A onda, proglasite ga:

#### JAVNI KONKURS Za popunjavanje radnog mesta

Naziv radnog mesta: Glavni službenik za javnu higijenu u Operativnoj jedinici u Prištini u KRM-u "PASTRIMI" SH. (1) pozicija;

Odeljenje: **Operativni direktorijum;**

Referentni broj: **DO / KJ-08/2025;**

Mesečni koeficijent / plata: **Nivo XI;**

Trajanje ugovora: **Unseatable vreme.**

Probni period: **3 meseca**

#### Dužnosti i odgovornosti:

- organizuje, prati i kontroliše realizaciju radova definisanih nalogom za rad koji se odnose na održavanje i PASTRIMI puteva i drugih površina definisanih Operativnim planom;
- proverava radnike u javnoj higijeni u pogledu ispunjavanja obaveza i prijavljuje nepravilnosti ili prepreke u radu;
- U slučajevima kada iz objektivnih razloga higijenski radnik ne ispunjava prihvaćenu dužnost, on upućuje drugi prostor za PASTRIMI prema operativnom planu;
- U slučajevima nesreće ili opstrukcije u radu, učestvuje i pažljivo posmatra stanje sanitarnih radnika;
- I druge stvari koje su potrebne od strane vođe.
- Za svoj rad odgovara vodi jedinice za javnu higijenu.

#### 2. Opšti kriterijumi za prijem na dužnost:

- ✓ da bude državljanin Republike Kosovo;
- ✓ Da imaju punu sposobnost da deluju, u skladu sa važećim zakonima;
- ✓ da poseduje najmanje jedan od službenih jezika, u skladu sa Zakonom o jezicima;
- ✓ Biti u stanju da izvrši odgovarajući zadatak;
- ✓ Da ne bude osuđen za izvršenje krivičnog dela;
- ✓ Imaju obrazovanje, profesionalno radno iskustvo i / ili veštine potrebne za poziciju;
- ✓ Uspešno proći procedure prijema utvrđene u ovom zakonu.

#### 3. Opšti formalni zahtevi

- ✓ Potrebno obrazovanje: Visoka stručna sprema ili srednje obrazovanje;
- ✓ Potrebno radno iskustvo: 2 godine radnog iskustva u odgovarajućoj oblasti

#### 4. Znanje, veštine i kvalitete potrebne u postupku zapošljavanja

- ✓ Sposobnost logičkog zaključivanja i analize;
- ✓ Komunikacijske veštine i lični uticaj, uključujući sposobnost predstavljanja;
- ✓ istraživanje, analitika, evaluacija i formulisanje preporuka i stručnih saveta;
- ✓ sposobnost donošenja nezavisnih stručnih presuda i ostvarivanja diskrecionog prava o pitanjima i davanja značajnog doprinosa razvoju i sprovođenju politike;
- ✓ Opsežno poznavanje oblasti, istraživačkih metoda, koje pomažu u pripremi osnovnih ili analitičkih izveštaja;

#### 5. Dokumenti koji se podnose u okviru prijave i način njihovog podnošenja

- ✓ Prijava popunjena i potpisana od strane kandidata;
- ✓ Kopije diploma koje dodeljuju obrazovne institucije;
- ✓ Kopija potvrde o zaposlenju (penzioni fond, potvrda ili ugovor o radu);
- ✓ Kopija dokaza o obuci i kursevima;
- ✓ Kopija procene rada za poslednje dve godine, (poželjno);
- ✓ Kopija lične karte;
- ✓ Dokaz da nije osuđen za krivično delo ne starije od 3 meseca.

#### 6. Način prijavljivanja na konkurs:

Zainteresovani kandidati, zvanični obrazac se može dobiti u kancelarijama za ljudske resurse u RM "PASTRIMI" SH.A.

Sve prijave moraju biti podnete elektronskim putem samo putem elektronske platforme: [punesimi.krmpastrimi@gmail.com](mailto:punesimi.krmpastrimi@gmail.com)

#### 7. Tačan datum i vreme zatvaranja javnog konkursa:

Javni konkurs traje 15 dana od: 17.02.2025 do 04.03.2025. Poslednji put prijema aplikacija je 4 posle podne.

Sve prijave koje stignu nakon isteka roka neće se razmatrati.

#### 8. Način vrednovanja i kriterijumi moći:

Evaluacija kandidata vrši se na osnovu biografije, pismenog testa i intervjua (usmeni test).

- ✓ CV kandidata se ocenjuje do deset (10) bodova;
- ✓ Pismeni test se vrednuje do sedamdeset (70) bodova;
- ✓ Intervjua (usmeni test) se procenjuje do dvadeset (20) bodova.

Postupak vrednovanja sadrži ukupno sto (100) bodova, pri čemu je prolaz ostvaren najmanje pedeset pet (55) bodova iz svih faza Javnog konkursa.

#### 9. Način obaveštavanja i komunikacije sa kandidatima:

Svi kandidati će biti obavesteni putem elektronske komunikacije i pojedinačno.

#### 10. Približan raspored postupka zapošljavanja:

Konkurs je otvoren do 04.03.2025. godine.

Preliminarna faza verifikacije prijava do 7 dana;

Faza pismenog testa do 10 dana nakon faze verifikacije;

Faza intervjua do 7 dana nakon objavljivanja rezultata pismenog testa;

Objavljivanje rezultata do 5 dana nakon evaluacije intervjua.

**Napomena:** Nesastavljeni, neskenirani dokumenti i oni koji stignu nakon isteka roka za konkurs neće biti pregledani.

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Feim Thaqi nga Qifllaku i Rahovecit shpall të pavlefshme dëftesat e klasës; I, II, III, IV dhe diplomën Gjimnazit "Xhelal Hajda", Rahovec, paralelet në Ratkoc.

- Valon Beqiri nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë.

- Donjet Gashi, nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e klasës 10, 11 të shkollës së mesme "Hysni Zajmi:", Gjakovë.

- Arlinda Kalimashi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë. Albert Mehmeti nga Brovina kk Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl. I të Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë paralele e ndarë në Ponoshec.

- Selmon Thaqi nga Gjakova shpall të pavlefshme nr. Unik Identifikues të biznesit me nr. 810120684.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Mërgim Uka nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 10 të sh,m,t "Nexhmedin Nixha" A. Mekanik.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Rizo Hodaj nga Kabashi KK Prizren shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.a.t. "Abdyl Frashëri" Prishtinë Bukëpjekës.

- Dulë Gjuraj Gerqinë KK Gjakovë, shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f.m.u. "Hamëz Cena" Demjan KK Gjakovë nga kl. 1-8.

- "Aroni DF" SH.P.K. shpall të pavlefshme numrin unik identifikues të biznesit 812228824 lëshuar nga ARBK.

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

Armir Krasniqi nga Demjan KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f.m.u. "Kongresi i Manastirit" Demjan KK Gjakovë nga kl. 1-5 dhe -6-9





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales





**MEKA**  
HALAL FOOD

# TRADITË QË NGA

# 1992

